

STACIONI I AUTOBUSIT

Shkruar nga

James Conor Patterson

PERSONAZHET

IRLANDEZI NIRI

SHËN PJETRI

SHOFERI I AUTOBUSIT

Role të tjera: ZËRI I ALTOPARLANTIT që njofton për autobusin e radhës

1. INT. KATI PËRDHES I NJË AUTOBUSI DYKATËSH. NATË.

Fërshëllima e hapjes së një dëre autobusi. Motori shuhet dhe marmita kërcet. SHOFERI hap derën e kabinës së tij dhe ecën në korridor, me hapa të ngeshëm, derisa ia dëgjojmë frymëmarrjen si të ishte ngjitur me ne.

SHOFERI

Lëviz, stacioni i fundit. Më presin tjetërkund.

IRLANDEZI zgjohet me brofje dhe mbushet me frymë thellë.

IRLANDEZI

Ku jam?

SHOFERI

Ç'rëndësi ka ku je? Marsh nga ky dreq autobusi. Nuk do rri të të pres ty!

Tingulli i shiut i shuan thujse gjithë zhurmat e tjera në sfond.

IRLANDEZI

Rënka shi me gjyma...

SHOFERI

E punë e madhe, shko futu te ai stacioni po e pe keq punën.

IRLANDEZI

...

SHOFERI

S'do rri të të pres ty gjithë natën!

Zhurma e karriges, prej ngritjes së IRLANDEZIT.

IRLANDEZI

Dhe ti ke ndërmend të më lësh këtu?

SHOFERI

Oj të lënë!

IRLANDEZI psherëtin.

IRLANDEZI

A mund të më thuash sa është ora të paktën? Kur vjen autobusi tjetër?

Zhurma e SHOFERIT që kthehet në kabinën e tij dhe mbyll derën.

SHOFERI

Me siguri që të kthen përgjigje ai burri atje.

Tingulli i derës që mbyllet dhe i autobusit që niset. Zhurma e shiut shtohet.

IRLANDEZI

Prit... prit...

Zhurma e autobusit të cilit i shtohet gazi diku më tutje dhe vazhdon rrugën.

IRLANDEZI

Hë, kokërr legeni...

Duke thyer murin e katërt, IRLANDEZI i drejtohet dikujt që po e vështron. Ndoshta neve, po pse jo dhe Zotit.

IRLANDEZI

Kështu më ka shkuar gjithë jeta. Më thonë të iki, s'më
lënë të kthehem, ma ndalojnë hyrjen. Në fakt, sonte
isha... isha... e po ç'është kjo çmenduri. Si s'më
kujtohet më ku isha? Po bëja llafe me njërin te
kalata, se nuk më kthente shishen, kur... kur...

2. EXT. NJË STACION AUTOBUSI PA NJERËZ, NDRIÇIM I DOBËT, NJË RRUGË E BRAKTISUR FSHATI.

Tinguj hapash, IRLANDEZI shkon drejt stacionit. IRLANDEZI murmurit me vete ndërsa lexon tabelën e orareve të ngjitur në murin e pasmë të strehës.

IRLANDEZI

Ferr... Purgator... Parajsë...

Filli i mendimeve të IRLANDEZIT këputet nga ZËRI I ALTOPARLANTIT të stacionit të autobusit. Është i lartë dhe flet me një theks të butë irlandez, pa u kuptuar se cilit dialekt lokal i përket.

ZËRI I ALTOPARLANTIT

Faleminderit që udhëtoni me *EternaBus*. Pritet të mbërrijë autobusi me numrin... gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë për në... Ferr. Iu bëjmë thirrje pasagjerëve për në... Ferr.

IRLANDEZI i kthehet burrit që rri ulur në stacion, që prej çastit të mbërritjes së tij.

IRLANDEZI

Më fal, zotëri, se mund të duket pak si pyetje idiote... po në Dublin jam akoma? Kisha pirë ca si shumë dhe më duket se më zuri gjumi në autobus. E pabesueshme, hë? Ha ha ha!

PJETRI

...

IRLANDEZI

S'i njoh këto anë. Mos është Ferri ndonjë lagje e re,
a si? S'më duket se... sikur s'e kujtoj si përfundova
këtu.

PJETRI

...

IRLANDEZI psherëtin.

IRLANDEZI

A më thua dot orën, të paktën? Gjëja e fundit që
kujtoj është një kacafytje me një dorë çunash të
rinj...

PJETRI

Të ka ardhur çasti i gjykimit, irlandezi Niri.

IRLANDEZI

Si? Po... E ti nga dreqin e di emrin tim?

PJETRI

E kam ditur gjithë jetën, irlandez. Nuk më njeh mua?

Një heshtje e shkurtër, ndërsa IRLANDEZI e mat me sy burrin.

IRLANDEZI

Ngjan pak me atë tipin e "Kush do të bëhet
milioner?"¹, po, po ta them troç, që as që e kam idenë
kush je.

PJETRI

E ke dëgjuar ndonjëherë atë këngën e Stonsave?
"Keqardhje për djallin"?²

¹ Konkurs televiziv me pyetje.

² I referohet këngës: "Sympathy for the Devil" nga Rolling Stones.

IRLANDEZI

Po, edhe?

PJETRI

E po, unë nuk jam ai.

IRLANDEZI

Në rregull.

PJETRI

Po jam dikush. Një i rëndësishëm.

IRLANDEZI

...

PJETRI

Pa kujtoje pak Biblën.

IRLANDEZI

Je... Jezusi?

PJETRI

Jo, jo Jezusi, more karagjoz. Provoje prapë.

IRLANDEZI

Llazari?

PJETRI

Ai... ai mut Llazari?! Mos të dukem gjë si i varrosur për së gjalli?

IRLANDEZI

Jo, por...

PJETRI

Jam Pjetri.

IRLANDEZI

...

PJETRI

Si Pjetri i "Shën Pjetrit"? "Mbi këtë shkëmb unë do të ndërtoj kishën time"? I kryqëzuari kokëposhtë?

IRLANDEZI

...

PJETRI

Seriozisht nuk e ke idenë kush është Shën Pjetri?

IRLANDEZI

Oh, e di kush është, si s'e di. Po e kam pak të vështirë ta besoj që ti je ai burri i portave të fildishta.

PJETRI

Shikon gjë ndonjë portë të fildishtë ti?

IRLANDEZI

Jo?

PJETRI

Pra, ku mendon se je?

Tingulli i ZËRIT TË ALTOPARLANTIT që thotë prapë njoftimin diku në sfond, teksa IRLANDEZI flet sërish.

IRLANDEZI

Në Kabra?!³

³ Një rrethinë në veri të Dublinit.

PJETRI

Mos tall trapin, bir. As ti s'e beson këtë!

IRLANDEZI shfryn.

IRLANDEZI

Pra, këto janë të ashtuquajturat porta të fildishta, hə?

PJETRI

E saktë.

IRLANDEZI

E paskeni rrudhur dorën. I është shtrënguar rripi plakut?

Tingulli i një maje pene që gërvisht letrën.

IRLANDEZI

Ç'po shkruan?

PJETRI

Ato që po thua.

IRLANDEZI

E pse?

PJETRI

I përdorim për të të peshuar gjatë gjykimit.

IRLANDEZI

Gjykimi, hə?

PJETRI

Po, pikërisht.

IRLANDEZI

Dhe sa më shkon pesha po të të them që ti je një dëng plot me rrena?

PJETRI

Të them të drejtën, nuk je fort mirë.

IRLANDEZI

Po që s'kam folur me të madhin që pas kungimit të parë? Qetësi e madhe gjithë jetën time.

PJETRI

Oh, po, këtë e dimë. U ngatërrove që në shkollë me ata barbarët e vegjël dhe ia fale shpëtimin tënd të përjetshëm ateistit Riçard Doukins⁴. Mëkati i tij më i madh është të shkruarit për faqe të zezë.

Tingulli i ZËRIT TË ALTOPARLANTIT dëgjohej në sfond.

PJETRI

Shiko, irlandez, zëre se ka ardhur autobusi i ferrit dhe ke një mundësi të fundit ta shpëtosh veten. S'do të thuash asgjë që të mbrohesh?

IRLANDEZI

Autobusi i ferrit, hë?

PJETRI

Po.

IRLANDEZI

Mos...

⁴ Riçard Doukins (*Richard Dawkins*) është biolog evolucionar dhe shkrimtar. Si ateist, është me nam për kritikën ndaj teorisë së krijimit dhe të modelimit integjilent.

PJETRI

Oh, jo.

IRLANDEZI

A më çon në rrugën *Sheriff Street*?

IRLANDEZI shpërthen në të qeshura. PJETRI murmurit me vete.

PJETRI

E po, u përpoqa, Atë.

E qeshura e IRLANDEZIT mpaket.

IRLANDEZI

Çfarë the?

PJETRI

Thashë që u përpoqa... po ti je copë mishi me dy sy.
Nuk ke vërtet pikë dëshire ta shpëtosh veten?

IRLANDEZI

Jo, në fakt, jo.

Tingulli i motorit dëgjohej diku larg. Automjeti sa vjen e afrohet, derisa dëgjojmë tingullin e njohur të një autobusi që ndalet, frenat shfryjnë e çlirojnë ajrin dhe dyert hapen. ZËRI I ALTOPARLANTIT thotë: "Gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë për në... Ferr."

PJETRI

Koçia po të pret, çuno.

IRLANDEZI

Po...

SHOFERI i ndërpret, duke thirrur nga kabina drejt trotuarit.

SHOFERI

Nxito, Niri, s'do rri të të pres ty gjithë natën!